- Krejt e veçantë, - i përgjigjej ai. - Madje prej këtij çasti do të jetojmë me dashuri dhe me ujë rubineti.

- Ok! - ia priste ajo. - Por me kusht që të ketë ujë ditë e natë.

- Doemos, - ia kthente ai, - ndërsa energjia elektrike kurrfarë rëndësie nuk ka.

Ditë pa numër

Dhe, në vend që të binin në gjumë, kalonin menjëherë në veprim. Po t'i pyeste kush, nuk do të dinin të thonin në varej kjo nga fakti që e kishin barkun të zbrazët, vetëm se që të dy e merrnin vesh pak a shumë që patën mbërritur në kulmin e një furie ende të panjohur deri atë ditë. Dhe iu desh atij ta bënte të tijën në të gjitha mënyrat e mundshme, madje të shpikte mënyra të reja, në kohë e sipër që i tregonte ajo të fshehtat e saj, se si gjithmonë ia kishte patur ënda të bënte dashuri, si qysh kur kishte qenë e vogël ishte ngacmuar jo vetëm me dorë, por me çfarë të mundte, ndërsa prindërit e ndëshkonin, nuk dinin si ta ndalonin, kurse i vëllai e përgjonte oreçast.

Kur Aristoteli fliste për lëvizjen eliptike të trupave qiellorë si për diçka “të amshueshme”, ai kishte patjetër parasysh vegimin e një kohe të kthyeshme e të rikthyeshme, të një “të tanishmeje të përhershme”. Dhe iu duk atij se përjetonte kështu rremësimin e një rinie të dytë, parandjesinë e një jete të re, dhe nuk llogariste më tani sa herë qe prishur, brenda saj, në gojën e saj, kudo mbi kurmin e saj, vetëm ndiente si e thëthinte ajo deri në pikën e mbrame të kënaqësisë së saj për ta ndier veten, sikur po

mësohej të thoshte, femër deri në skajin e skajit, e dergjur në kanape, me sytë të përvdirur si për të pritur sa ai ta stërpikte edhe një herë, nervozisht, dhe mbas kësaj të dergjej edhe ai, gjysmë me ndjenja e gjysmë pa ndjenja, me trupin larë në djersë, me tamblat që i buçitnin dhe ndjesinë e zbrztisë në kokë e në bark, deri kur ligshkrimin e tij ta kuptonte edhe ajo, të përkulej mbi të dhe ta pyeste:

- Nuk ndihesh mirë?

Ai i kishte kopsitur qepallat e lodhura, duke u rrekur me mundim ta fashiste çrregullsinë e të rrahurave të zemrës, porse për ta qetuar atë i çeli paksa, dhe dalloj fytyrën e saj ngjithmas së tijës, dhe pati fuqinë të vinte buzën në gaz e të thoshte s'është gjë, s'është asgjë, mirëpo ja që ajo nuk e besoi, brofi nga shtrati dhe zuri të vente e të vinte ngutshëm nëpër dhomë, dritë nuk kishte, por hëna që hynte nga dritaret, prej grilave të ngritura, e shndriste dhomën sa që e panevojshme të ndizje një shkrepëse, po vishem dhe po dal të ble diçka për të hangër, i tha, ti ke uri, kjo është e gjitha, dhe mbase kjo që e vërtetë, vetëm se duhej të kishte kaluar prej kohe mesnata dhe shitoret sigurisht që qenë të mbyllura prej kohe, revolucioni kishte ligjet e veta, dhe ai ia kujtoi këtë, kështu që tani ishte ajo që e këqyri e çmeritur, po si t'ia bëjmë, i tha, nuk kemi ç'bëjmë veçse të presim mëngjesin sa të hapet ndonjë shitore qumështi, mërmëriti ai, punë orësh duhet të jetë, dhe atëherë mund të dal unë vetë, atëherë ajo erdh e iu ul pranë, mendon se mund të durosh deri atëherë, e pyeti, dhe ai i buzëqeshi si nëpër vagulli, dhe ja ku befasi e ndjeu veten keq, shumë keq, sidoqë nuk ishte aspak i shqetësuar për fatin e vet: pakëz prehje, një të hangër të paqme dhe do ta merrte veten,

mbase edhe vdes para se të fillojë shitja e qumështit bolshevik, tha me zë, por a nuk do t'ia vlente vallë të vdesësh në krahët e tu, dhe ajo i hidhej mbi kraharor duke e shtërnguar ngjitmas, atë herë do të vdes edhe unë me ty, klithte me zë të lektisur, të vdesim bashkë, dhe skajohej ai paksa për ta këqyrur më mirë, po sikur të ishte e vërtetë, i tha papritmas, po sikur të vendosnim të vdisnim duke bërë dashuri, a nuk do të ishte një vdekje e denjë për ne, dhe tundte ai kokën, them se do të qe më mirë të pritnim edhe një grimë, ndërkohë mund të vëmë te dera e apartamentit kartelën "*Do not disturb: We are looking canal +*", në mënyrë që i sapoformuari "komitet i banesës" të na lërë të vdesim të qetë, atëherë ma bëj, i lutej ajo me zë të ngjirur, ma bëj, ma bëj edhe një herë, ma bëj papushim, ma bëj përgjithmonë, ma bëj përjetësisht, dhe ai nuk dinte në i fliste ajo kështu apo i vinte atij mendja rrotull dhe, ndonëse dergjej në kanape, kishte përshtypjen se pluskonte në mesin e lartësisë mes tavanit dhe velencave, i gjithë trupi i ngjante se i shkumonte ose, më sak, sikur mijëra gjilpëra ia shponin mishin së brendshmi, dhe megjithëkëtë e lëshonte veten duke e kuptuar çfarë plani kishte ajo, dhe ai do të kishte dashur t'i thoshte të priste, ta linte për një copë herë të mbushej me frymë, por fjalët mezi i delnin nga goja dhe, para se të arrinte të nyjëtonte të parën, e pikasi se, në të vërtetë, as që kishte ndonjë dëshirë që ajo të ndalej, përkundrazi.

Jashtë duhej të ishte në të gdhirë, kur ai u kthye me një shishe qumësht të mazitur, bukë dhe vé, si dhe me gazetën *Volja Naroda*, që atij mëngjesi kishte nisur të delte së rishti. Provuan të ndiznin dritën, por dritë vetëkuptohet që nuk

kishte, kështuqë u mjaftuan me ndriçimin e zjarrit të shporetit. Pianoja e çakorduar, diku nga katet e sipërme, kishte nisur nga dringëllitja. *Volja* botonte urdhrin që Kerenski paskësh lëshuar nga Pskovi. Në emër të shpëtimit të atdheut, komandantët dhe komisarët urdhëroheshin të mbanin postet e tyre, ashtu si dhe vetë ai mbante postin e kryekomandantit të përgjithshëm derisa të shprehej vullneti i Qeverisë së Përkohshme. *Volja* njoftonte edhe krijimin e “komitetit të shpëtimit të Jugut”, ndërkohë që Kongresi i Sovjetëve bënte të ditur se ish-ministrat Konovallov, Kishkin, Tereshçenko, Maljantoviç, Nikitin etj., ishin rreshtuar. Urdhëroheshin të gjitha organizatat e ushtrisë për të rreshtuar në vend Kerenskin dhe për ta dërguar në qendër. Çdo bashkëpunim me të do të ndëshkohej si krim i rëndë kundër shtetit. Asnjëri prej të dyve nuk e dinte mirë kuptimin e fjalës së saposhaqur “rreshtim”, por nga nënkteksti i ngjarjeve e morën me mend se çfarë donte me thënë, se nuk qenkësh e re por përkundrazi e vjetër, ndërsa gërvalleshin sa mundnin me “krimet kundër shtetit” dhe e pinin qumështin të ftohtë, me gërqe të gjata e gjithë eshk, të zdërgjahur në kanape.

E shtrirë ngjat heroit, i tregonte ajo se si e kishte parë dikur, në një nga mesditët verore kryeqytetase, me kostumin e lehtë prej flaneli, tek ecte nën hijen e pishave të shëtitores drejt diellit, me flokët në erë dhe sytë që i shkëndinin, si një bishë vetmitare, qysh atëherë mendova se ti nuk u ngjaje të tjerëve, i thoshte ajo, madje se ky duhej të ishte tipari yt kryesor: të mos u ngjaje të tjerëve, por sakaq ai i premtonte se me ato vé të sapoblera do t'i gatuate diç të veçantë, po krejt të veçantë, dhe ajo e pranonte, dhe e ur-

dhëronte ai të shtrihej përmbys, dhe i bindej ajo në kohë e sipër që e këqyrte e habitur, mos ki frikë, i thoshte ai, nuk kam, ia kthente ajo, mund të më përmbytësh me dashurinë tënde, dhe që ajo një shprehje që ajo për herë të parë ia thoshte, ndërsa, e kredhur me fytyrën në velenat e kuqe, e ndiente së rishti mbi vete, ai i lëpinte shpinën, e guduliste me gjuhë, i zbriste teposhtë e i rrëshqiste mes mollaqeve, dhe gjuha e tij që e nxehtë, ajo kishte mbyllur sytë dhe dridhej, në kohë e sipër që gjuha kërkonte nëpër shtegun e saj të fshehtë, në fillim lehtas, mandej gjithnjë më me ngulm: lëpinte, thithte, puthte pikërisht atje tek kurmi i saj vinte e bëhej më i ndjeshëm, lëshojte veten, i pëshpëriste ai, mos mendo për asgjë, ki besim tek unë, dhe ledhatimet e tij e detyronin që edhe ajo të zhvendosej, të lëvizte, duke e harkuar kurmin e saj mbas gojës së tij.

Vijonte ajo t'i mbante sytë të mbyllur dhe vetëm nga kërcitja e kuptoi se ai e theu një vé, ktheu kokën dhe e pa se si e pinte të gjallë, mandej theu një të dytë, dhe ajo u drodh si prej rrymës elektrike kur ndjeu tek ai ia derdhte atë vé mbi ijet e saj, u përqeth dhe deshi të rebelohej, por ai e urdhëroi të rrinte urtë, "uuurtë", dhe zëri i tij për herë të parë i kalli diç të ngjashme me frikën. Që véja e derdhur të mos hapërdahej, ai u përkul mbi shpinën e saj, mbërtheu me dhëmbë të verdhën dhe me gishtërinj e shpuri drejt shtegut mes mollaqeve të vajzës, i çmendur, mërmëriti ajo, por ai e urdhëroi së rishti të bindej, dhe zëri i tij ishte edhe më i rreptë, ai e fërkonte vénë e derdhur mbi ijet e saj, ia ngrinte vithet, ia hapte mollaqet dhe i kallte një gisht në shtegun që ai e dinte se do ta rrihte për herë të parë, dhe ajo tanimë kishte mbetur pa frymë, dhe kur ai i tha se e

kishte të gjithë të verdhën e vésë brenda, ajo nuk dinte çfarë të thoshte pos se të mërmëriste: e kam për herë të parë, një fjali që po atë grimë i bëri të zgërdhieshin të dy, për herë të parë e kam edhe unë, ia kthente ai me zë gati-gati të bardhë, dhe asaj ia kishte mbështjellë kurmin një djersë e hollë, të cilën ai ia nuhaste gjithë neps, ndërsa i depërtonte mes mollaqeve, duke ia sulmuar drejtpërsëdrejti shtegun e herës së parë, dhe le të rënkonte sa të donte ajo tani, le të përpushej e të përpëlitej, kjo virgjëri i takonte atij, dhe ai tani këtë virgjëri po e merrte, dhe e këshillonte ai të kafshonte nënkresën me dhëmbë, dhe asaj nuk i mbetej pos se të bashkëpunonte në mënyrë që e gjitha kjo të përfundonte shumë shpejt, kur ai të prishej mbas disa çastesh.

Nuk doli menjëherë prej saj, priti të qetoheshin të dy, t'u fashitej çmenduria e zemrave, që dalja të ishte sa më pak e dhembshme, dhe atëherë ajo u kthye nga ai, dhe u puthën ata të dy si të marrosur, jam çliruar aq fort, i tha ajo, sa më zukasin veshët, dhe i kërkoi ajo një vé tjetër t'ia thyente në dorë, ndërsa nuk ia tregonte se përse e donte, dhe ia derdhi ai vénë në pëllëmbët e hapura, dhe ajo ia rrokte mashkullorinë e tij me një ato duar, duke e lëvizur poshtë e lart, gjithë ëmbëlsi e epshëri, madje me shpejtësi, gjithnjë me më shumë shpejtësi, deri kur ai ia stërpikoi së rishti me lëngun e tij fytyrën, deri kur mbetën të dy si shakuj në kanape, pa u mbushur dot me frymë.

Tanimë gjallimi nuk ishte më pos se përmbushja e përsëritur, e stërpërsëritur e një dëshire të vijueshme dhe, sikur ai të kishte patur fuqi, do të qe përpjekur t'i shpjegonte vajzës ngjitmas tij parimin aristotelik të lëvizjes eliptike të

trupave qiellorë, atë diçkanë “e amshueshme”, vegimin e kohës së kthyeshme e të rikthyeshme, të “së tanishmes së përhershme”, por kurrfarë fuqie për asi shpjegimesh ai tani nuk kishte, dhe qenë gati ata të rrinin në shtrat ditën dhe natën, pa lënë as diellin të hynte në dhomë, t’i ulnin grilat, t’i mbyllnin perdet, t’ia pengonin hyrjen botës së jashtme, madje ta mbrapakthenin edhe vetë revolucionin bolshevik, dhe për të hangër t’u mjaftonte vetëm shtrati: rast i mrekullishëm për gërvallje e marrëzi, sepse mbas hajes vinte gjumi, një gjumë i habitshëm, që përretej në dashurinë e tyre, dhe e ndienin veten ata si dy kredharakë kokëfortë që kthehen në sipërfaqen revolucionare vetëm sa për t’u mbushur me frymë, mandej kridhen së rishti për t’u shkredhur në sipërfaqen e përkundërt, d.m.th. atë kundërrevolucionare, ku mund të dalin edhe në mes të ditës, të ulen nën një korije të vogël që ngrihet mbi shtëpizën e tyre, të rrijnë aty e të mbajnë vesh harmonitë gazulluese të mesditës së përdiellur, duke ëndërruar orën e afërt që do t’i lërë deri të nesërmen në krahët e njëri-tjetrit.

Por, ah! Heroi ishte i sigurt që revolucionin atë punë kishte: do të vijonte të përsëritej e të ripërsëritej ciklikisht simbas parimit leninist dhe ajo çfarë vetja e tij e dyzuar përfytyronte s’qenkësh veçse një skenë idilike e një shkrimtari të tij të dashur, madje edhe ajo e hequr prej vetë shkrimtarit në botimin përfundimtar të veprës në vitin 1972 ose 1872.

E dyta ditë pa numër

Para tyre rrugët e terrshme të qytetit vagullonin, valaviteshin të trishtme nëpër shiun e pistë. Era nga lindja vijonte të sillte vetëm lagështi, ndërkohë që për aeroportet nuk kishte ende kurrfarë njoftimi hapjeje. Ai kishte dashur ta shoqëronte dhe ata kthenin nga agjencia e mbyllur e fluturimeve. Qielli i grinjtë, që dukej sikur mbështetej mbi çatitë e ngrehinave të vjetra, kullonte i tëri nga lart poshtë. Si kalldrëmet, si asfaltet qenë veshur me një baltë mbi të cilën mund të rrëshkitje pa një, pa dy. Edhe në trotuarët karroca dhe trame, që ngrinin ujërat e rrugës, flakëritnin o-reçast spërka balte. Muret ishin mbushur me postera, por gazeta të reja nuk kishte. Demaskime. Thirrje. Dekrete. Njëra nga afishet shpallte shërbimin e detyrueshëm ushtarak të punëtorëve nga gjashtëmbëdhjetë në dyzet vjeç. Rroga, e njëjtë dhe e barabartë: 300 rubla. Racioni i përgjithshëm: ½ kg. bukë, 40 gr. mish (ose peshk), 60 gr. zezavate, 12 gr. oriz (ose makarona), 10 gr. yndyrë, 10 gr. sheqer dhe ½ gr. çaj. Në një pllakatë të madhe ishte varur manifesti antibolshevik i KESDF: Komitetit Ekzekutiv të Sovjetit të Deputetëve Fshatarë. Të struktur nën palltot e rënda, çapiteshin nëpër ato rrugë ata të dy, dhe balta e ftohtë u depërtonte në

shojet e trasha të këpucëve, sidoqë të dy kishin mbathur edhe galloshe për t'iu përshtatur dimrit revolucionar.

Kalimtarë pyetnin njëri-tjetrin:

“Po vijnë?”

“Ende jo...”

“Ç'të reja kemi?”

“Nuk di asgjë... Ku është Kerenski?”

“Flitet se është vetëm tetë vjorsta larg kryeqytetit...”

“A është e vërtetë se ata të kryqëzorit *Aurora* kanë marrë bazën e Pasha-Limanit...?”

Ecte ajo përbri tij, në heshtje, e vetëdijshe për faktin që, nën fustanin e kadifenjtë poshtë palltos, e kishte bar-kun lakuriq, sikurse e kishte këshilluar ai të vishej. Ndonëse nëpër rrugë nuk kishte dritë të mjaftueshme, atij i dukej se ia shquante me një tjetër shqisë vijën e shpinës, thellimin e gjatë e të errët që humbte teposhtë mesit. Por ndoshta kjo kishte të bënte vetëm me mjegullën e bezdishme që po e pllakoste së rishti qytetin dhe me faktin që vajza përbri tij e kishte pjesën e poshtme të trupit të kredhur në atë terr të lëngshëm.

Makinat private i kishte sekuestruar Komisariati i Popullit, kryesisht për t'i përdorur për varrimin e të vdekurve, por të paktën njëra nga linjat urbane punonte. Kioskat dhe restorantet qenë hapur, madje thuhej se Teatri Kombëtar, ndonëse pa drejtor efektiv, vijonte shfaqjet dhe Galeria e Arteve kishte gjithnjë vizitorë. Nuk mund të ketë gjë më të çuditshme, mendonte ai, se gjallëria e organizmit shoqëror, i cili i vijon të gjitha funksionet e veta, ushqehet, vishet, argëtohet, qoftë edhe në kohën e fatkeqësive të mëdha, madje ja, edhe tani që ishte shpallur

“gjendje e jashtëzakonshme” dhe qenë ndaluar mbledhjet, mitingjet dhe gjithë grumbullimet në rrugë, sheshe apo mjedise të tjera. Shumica e *boutiques-ve* të rrugës *Tvjerskaja* qenë ende të hapur. Hoteli *Metropol* shkëndinte nga dritat dhe potera. Pa mbëritur në sheshin *Strastnaja*, kafe *Bumi* vijonte të ishte citë me të rinj me flokë të gjatë, që pinin duhan me pipa dhe zdërgjaheshin me *prostitutka* nëpër kanapetë përgjatë qelqeve të dritareve të rrugës. Shikojua flokët, i thoshte ai vajzës. Përse? e pyeste ajo. Dallohen që janë të vërteta. Të vërteta, në ç’kuptim? Në kuptimin që, kur riprodhohet një epokë historike, dështohet rëndom pikërisht në ndonjë hollësi të vogël si puna e flokëve. Nuk të kuptoj. Ta shpjegoj kur të shohim bashkë *Doktor Zhivagon*. Regjisori pikërisht te flokët ka dështuar. Të gjithë femrat, nga Ana te Lara, janë krehur mbas modës së viteve ‘60 dhe jo simbas stilit të viteve të Revolucionit tonë.

Dy kompani junkerësh kalonin me hap ritmik përgjatë *Tvjerskajës*, rreshtat e tyre kalamendeshin midis brymës së ulët në mënyrë qesharake dhe gjatë ecjes këndonin një këngë të vjetër ushtarësh të carit, çdo strofë e së cilës fillonte me vargun: “Tungjatjeta! Tungjatjeta!” Në kopshtin kundruall, mbi shtatoren e bronzte të poetit shtetëror, kishin ngulur një flamur të vogël të kuq. Në udhëkryqin e parë vunë re se policia tani i patrullonte rrugët kaluar më kuaj dhe e armatosur me revolverë, të cilët i mbanin në këllëfë që vetëtinin. Grupe të vogla njerëzish e kundronin këtë polici gjithë kureshti: nga të kishte dalë, vallë? Në qoshe të *Sheshit të Qeruve* blenë broshurën e re *A do ta mbajnë pushtetin shtetëror bolshevikët?* Bënte diçka si një rubël e dhjetë kopejkë, por më mbas atij do t’i kujtohej se e kishte pa-

guar me një kartëmonedhë nga ato që qarkullonin tani në vend të monedhave të vogla metalike.

Tramet kalonin të mbushur deri jashtë me civilë dhe ushtarakë, si edhe me do individë të çuditshëm që nuk ishin as civilë as ushtarakë, ose që ishin të dyja bashkë. Përgjatë mureve rrinin në radhë dezertorë veshur në uniforma, të cilët shitnin cigare, farëza luledielli dhe, vetëkuptohet, “miell”. Sidoqë ishte mjaft e vështirë të kapje një tram, dikur ia arritën. Dhe, kur ia arritën, atij se përse iu përngja më shumë si një trolejbus. Gjindja brenda qe rrasur ngjitmas, tymi i duhanit pa filtër të zinte frymën, era e djersës të merrte mendtë. Vajza ndjeu mashkullin mbrapa që thujse i qe ngjitur për trup, sikurse edhe ajo vetë i qe rrasur nga mbrapa burrit që e kishte përpara. Ndiante mbas qafe frymëmarrjen e ndezur dhe, papritmas, këmbën që rrekej t’i kallej midis kofshëve. Reagimi i saj i parë qe të zhvendosej pak më përpara. Ishin në tram, dreqi e mori! Por këmba nga mbrapa nuk i shqitej. Madje filloi të lëvizte ngadalë, të ngrihej lart, të ulej së rishti poshtë.

Nën pallton e madhe, buzët mes kofshëve të saj, pa të mbathura, ishin ende të enjtura nga dashuria. As gjysmë ore më parë nën fustanin e kadifenjtë ata sapo ishin ndeshur mbi kanapënë me velenca të kuqe. Ajo kishte qenë duke lexuar, ndërsa ai delte nga dushi. Bëheshin gati 24 orë që nuk kishte pasur ujë. Tani më thuaj ti, e kishte pyetur ai, se si ke dëshirë të ta bëj. Kjo përmbysje e gjendjes e kishte lënë vajzën të druajtur. Si të duash ti, kishte pëshpëritur. Dua të ma thuash ti si të pëlqen. Më pëlqen thjesht të ma bësh, kishte pëshpëritur ajo. Si? kishte ngulmuar ai. Nga mbrapa, dhe të ma bësh fort. E kishte shtyrë ai m’anësh dhe ia kishte rrasur bre-

nda sa çel e mbyll sy. Aq e njomur kishte qenë, sa muskujt e fshehtë i qenë tkurrur në çast. Të lëviz shpejt apo ngadalë? e pyeste ai. Ngadalë, edhe më ngadalë, i pëshpëriste ajo, dhe njëkohësisht më ledhato gjinjtë. Kështu? Mirë? Të pëlqen? Pooo... Ai i kontrollonte lëvizjet e tij, i vëmendshëm që ajo të mos prishej shpejt. Thuajmë se çfarë ndien. Të ndiej ty: je më i mirë se gishti yt, më i mirë se gjuha jote, më pëlqen më shumë nga gjithçka, do të çlirohem vetëm kur të më thuash ti, i kishte thënë ai, më thuaj kur të jesh gati.

Ajo tani orvatet edhe një herë t'i ikë këmbës mashkullore, por ajo, në vend që t'i shqitet, ka filluar t'i fërkohej mbas kofshës. Në fillim palltoja i duket, gjithsesi, një mbrojtëse e mirë kundër asaj këmbë. Por, krejt e pakënaqur vetëm nga takimi me cohën e palltos, këmba orvatet t'i kalojë nëpër të çarën e palltos. Ka takuar mëndafshin e zi të çorapeve të saj. Atë e zënë të dridhurat. E morët vesh lajmin e ri? pyet dikush në krah të saj. "Ata" do t'u kërkojnë nëpunësve të kthejnë të gjitha rrogat që kanë marrë para vitit 1917. Vajza nuk është e sigurtë në kanë thënë 1917 apo 1997, ngase mendjen e ka gjithnjë te këmba, që ka qëndruar një hop pa lëvizur, si për të pritur kundërveprimin. Të ftohtit dhe absurditeti i situatës e bëjnë të dridhet keq. Më shpejt, i qe lutur ajo aty e gjysmë ore më parë mbi kanapenë, më shpejt. të lutem! Ngjitma barkun mbas vitheve! Futma deri në fund! Të pëlqen kështu si po ta bëj? e pyeste ai. Po, më pëlqen, ia kthente ajo. Po, po prishem. Mandej kënaqësia qe hapur nga mishrat e saj të brendshëm te kofshët, te mollaqet, te gjinjtë, për t'i shpërthyer së fundi në një gulçim të lëngshëm. Ai qe çliruar pa dalë prej saj, me aq furi, sa ajo kishte patur përshtypjen se i kishte mbërritur në qafë që në libra e quanin "të

uterit” dhe ajo e përfytyronte si një qafë të vërtetë mali. Kishte qenë një përjetim marramendës. Kur qenë qetësuar, ajo ishte mbështetur mbas tij dhe, për herë të parë, i qe dukur se e pati kuptuar pushtetin e fjalëve. Ai i gëdhelte kraharorin e hajthëm duke i pëshpëritur: “Je vërtet shumë e bukur kur bën dashuri”.

Të ishte vërtet e bukur kur bënte dashuri?

Tani këmba i fërkohet mbas pulpës së djathtë, duke u rrekur të ngjitet ngadalë deri te kofsha. Ngrohtësia e trupit mashkullor e kaplon me të shpejtë, duke e bërë të provojë një ndjesi mirëqenieje. Gjithnjë duke iu fërkuar mbas kofshës, një luhajtje e legenit të barkut i kalohet, si pa kuptuar, vitheve të saj. Duket sikur këmba skajohet për një hop, por ajo nuk ka kohë as për të gjetur një shpjegim, kur këmba është kthyer së rishti dhe kësaj here ndien dorën që i kallet nëpër të çarën e palltos. Ajo fërgëllon, e elektrizuar, gati-gati qysh para se dora ta prekë. Gishtërinjtë i gëdhelin vithet nga përsipër fundit me lëvizje që ajo tanimë i njeh. Mandej e gjithë dora mbështetet duke rrëshkitur drejt kofshëve. Ajo i mban këmbët të shtrënguara, por dora mjaftohet edhe duke i prekur kofshët, mollaqet. Tani nga gëdheljet, ka filluar të njomet. Ka përshtypjen se, ngaqë nuk ka të mbathura, po kullon teposhtë këmbëve. Ajri i ftohtë që hyn nga e çara e palltos ia rreh kofshët dhe ngrohtësia e përcikjeve të dorës e rehaton. Trami kalon kështu edhe një ndalesë, radha zhvendoset së rishti. Ajo bën një hap përpara, ndërkohë që këmba nga mbrapa e ndjek menjëherë me një hap, ndërsa dora përfiton nga afrimi i ri për të depërtuar më thellë. Ajo mezi i bën ballë tundimit për t’u hapur edhe më. Dora lëviz ngadalë gishtërinjtë, duke i prekur pushin e nënbarkut. Nënbar-

ku i saj është bërë ujë dhe ajo ndihet e pambrojtur për të luftuar me kënaqësinë e vet. Fundja, kjo është vetëm një lojë dhe asgjë më. Kështu që ajo nuk duron dot më dhe i hap këmbët. Atëherë një gisht i kërkon të çarën flakëndezur. Ajo mbyll sytë, përfytyron gjuhën e vet kur ia lëpin heroit para se ai t'ia kallë në gojë, i bëhet se ndien në qiellzë të gojës shijen cukëse të lëngut mashkullor me të cilën tanimë ka filluar të mësohet, kur gishti i prek thupin dhe ajo mend këlthet nga kënaqësia, dridhet, vithet i shtrëngohen pavarësisht vullnetit të saj, ndërkohë që gishtërinjtë bëhen më të shpejtë, më të vrazhdë, më të guximshëm. Nëpër atë dyn-dje marramendëse të tramit, ajo shkon dorën e vet nën pallto për të gëdhelur njërin gj. E merr njëren thithë mes gishtit të madh dhe atij tregues, duke e shtënguar dhe duke e rrotulluar gjithnjë më shpejt. Rreket të imitojë kënaqësinë që provon kur ai i kafshon thithat e gjirit. Është një lojë që e çmend. Gishti brenda nënbarkut i lëziv gjithnjë më shkath-tësisht, dhe ajo ndien ngërçin përfundimtar t'i afrohet, t'i ngjitet për trup. Heq atëherë njëren prej dorashkave të gjel-bëra dhe zgjat dorën e çliruar mbrapa, për ta prekur drejt-përsëdrejti mashkullorinë e njohur, qoftë edhe sipër panta-llonave. Vetëm mbasi vala e kënaqësisë e ka përmbytur dhe ndërsa shtrëngon këmbët, e kupton se mashkulli që po prek mbrapa vetes nuk është *ai*. Pantallonat ngjitmas saj nuk janë *jeans 501*, por një cohë e trashë, më e ashpër. Të dridhura të reja e zënë. Si ta paskësh djegur ajo fryrje e fortë brenda pantallonave të panjohura, e tërheq dorën në çast. Nuk guxon të kthejë kokën. Sakaq trami ka mbërritur në një ndalesë tjetër dhe ajo e ndien veten pa mashkullin mbrapa. Ai që i kalon më të shpejtë përpara është një çunak i veshur në

uniformë ushtarake, njomëzak, korrozi, i paqethur e i parruar, që ndërsa zbret, i buzëqesh si ngadhënjmtar, madje i shkel syrin. Ka përshtypjen se, sikur ai të mos kishte zbritur, asaj do t'i binte të fikëtit. Vetëm kur trami niset së rishti, kujtohet ajo të kthehet mbrapa dhe të kërkojë heroin tonë. Ai qëndron dy-tri vende mbrapa saj, i ulur shtrëngueshëm në një ndjenjëse të ngushtë mes dy zonjash të moçme, dhe e vështron, kinse e sheh për herë të parë, madje shtiret sikur diç po lexon, ndoshta broshurën *A do ta mbajnë pushtetin shtetëror bolshevikët?* Dhe asaj i bëhet se ai nënqesh.

Kanë zbritur prej kohe nga trami dhe çajnë nëpër terrin e lëngshëm prej të cilit buron një dritësim i habitshëm. Asnjëri nuk e zë ngoje atë çfarë sapo ka ndodhur. Ai ia ka shkuar krahun për mesi dhe i kërkon me gishtërinj vijën e hijes, e cila tretet teposhtë shpinës së saj, në një humbellë të thellë. "*Si golle deti mbi të cilin pluskon një flur petalesh mbas stuhie*". Ia shëtit gishtërinjtë nëpër atë vijë, butësisht por vendosmërisht, dhe ndien në gishtërinj një epush të dendur, si t'i paskësh kaluar mollëzat e tyre mbi një metal të mbinxehur, të cilin ta ka frika ta prekësh e, megjithatë, ta ka ënda t'ia kalosh e t'ia rikalosh gishtërinjtë përmbi.

Rruga merr për poshtë. Çapiten ata shtrënguar njëri mbas tjetrit, duke e shmanguar me sa mundin ajrin që i ndan. Lagështia i akullon, era u fryn brinjë më brinjë duke fshikulluar harkadat përanësh rrugës, galeritë e mbuluara ku për çdonjërin nga të dy struken kujtime të së kaluarës të përjetuara veçmas, struket ai gjësend i paçansueshëm që i bën ata të dridhërohen, të hyjnë e të dalin si të fandak-sur nëpër libra duke kërkuar turbullimin e pambarimit, duke menduar për vise të mrekullishme që ekzistojnë përnjë-

mend dhe ku mund të shkosh e të endesh. Vijoje në kështu deri kur, duke zbritur prej valëve të natës, ai ulet poshtë për të kërkuar sytë e saj, mollëzat e faqeve të ftohta akull dhe buzët e përzhitura ndezullie:

- A mundem, *shoqe*? - pyet duke i afruar buzët e tij.

- Ju, *shok*, mundeni për gjithçka.

Të ndalur ashtu, mes territ të lëngshëm, ka kredhur ai kokën e vet në flokët e saj duke i kërkuar me buzë gushën, damarthin e dashur, ndërsa ajo e ka rrokur fort dhe e shtrëngon gjithë ankth. Është njëfarë agresioni i ndërsjelltë, mbas konsumimit të të cilit, me frymëmarrjen të prerë dhe sytë të mjegulluar, ndihen ata së rishti të lehtë, të papeshë, kinse paskëshin patur nevojë vetëm për një çast të gjenin mbështetje. "Po sikur një shkrimtar ta përshkruante këtë histori tonën, si do të duhej të vepronte?" pyet njëherë ajo. I dehur nga fjalët e saj, ai gati-gati e ka humbur vetëdijen e asaj çfarë flasin. Ndiejnë të dy tejpertej teshave takimin e trupave, diç të pakapshme e njëherësh të rrokshme. Si ëmbëlsi hyjnore qirinsh luhatës në mes të ditës në varrimin e një miku, i kujtohet atij.

- Di të them vetëm se, pikësëpari, do t'i duhej të binte në dashuri me ne, - përgjigjet.

- Me ty apo me mua?

- As me mua as me ty, por me njëshin që bëjmë ne të dy. Dhe gjithë sa do të shkruante do të ishte një dështim, po të mos që i dashuruar në të njëjtën kohë me këtë njësh.

Zgjat ajo dorën me gjithë dorashkë drejt zinxhirit të *jeans*-eve të tij dhe zbulon se atij i është ngrehur. Por edhe ajo vetë është njomur tanimë. Dhe të dyve, në të njëjtën kohë, u merren mendtë nga fryma kundërrevolucionare.

E treta ditë pa numër

Flitej se ministrinë e luftës e kishin marrë bolshevikët qysh në mëngjes, megjithatë kryqyteti vijonte jetën e vet. Blend Çudnovski, me sa dukej, ishte emëruar komisar i Pallatit të Verës, mbasi kishte realizuar djegien e plotë të tij. Thuhej gjithashtu se çdo gjë qenkësh OK, ndonëse me mijëra burra, gra dhe fëmijë nuk kishin më shumë se 25 gramë bukë në ditë. Qenë nisur ata për në ballon e *Qenit të tërbuar*, në kohën që retë, shiu dhe balta vijonin ta mbanin peng kryeqytetin. Kalimtarë të rrallë nën çadra mezi përballonin erën me to; të tjerë detyroheshin të mbanin kapellet me duar dhe të vinin shallat te goja. Rrugët ishin pothuaj të pandriçuara, vetëm te qoshja e *Moskovskajës* shëndrinte feneri mbi autobлиндën e vjetër; motori i autobлиндës ishte i ndezur dhe nxirrte shtëllunga tymi benzine. Vajza i qe lutur të merrnin një karrocë me qera dhe ja se ku tani pajtoni i tyre tresonte si mos më keq, duke ngritur rreth rrotave qerthuj balte. Jo sikur çanin nëpër rrugë, por sikur vozitnin nëpër një kënetë të vërtetë. Duhej ta kishin kaptuar *Moskovskajën*, kur nuk u mor vesh se prej nga u shfaq edhe një autobлиндë e dytë. Prej kullës së saj kishte qitur kokën një njeri, i cili thërriste diçka që tingëllonte si:

“Përpara për fitore të ra!”

Heroi qeshte e i tregonte vajzës episodin e pajtonit në të cilin Floberi kishte mbyllur Emën dhe Leonin, se si kalonte ai nëpër *Sen-Sëver*, nëpër bankinën e *Kyrandjesë* dhe atë të *Mëlit*, mandej edhe një herë nëpër urë, nëpër sheshin e *Fushës së Marsit* dhe mbrapa *Kopshteve të Spitalit*, se si shkrintari i gjorë e përshkruante gjithë këtë dekor përimtësisht, së toku me pleqtë në të zeza që shëtitnin në diell apo terracën me liana të gjelbëra. Spërkat e baltës shpërthenin si fishekzjarre nga të dyja anët e pajtonit të tyre. Prej shiut që hynte së kithi nga dyert, atyre iu desh t’i ngrinin qelqet, të cilat u vijëzuan në çast me currila. Përpiqeshin ata të vështronin përtej tyre dhe nuk dallonin tjetër veç disa rrotullamesh zjarri që vejevinin mes kënetës të mbështjella prej breroreve të verdheme të mjegullës. Duhej të ishin zjarret nëpër kryqëzime të ushtarëve dhe gardistëve të kuq. Si nëpër jerm dëgjoheshin të qeshurat dhe këngët e tyre të padeshifrueshme. Kishin dalë në bulevardin kryesor, kur vajza i tha se asaj i dukej sikur nuk ecnin me pajton, por pluskonin mes flakësh të lëngshme e të ndyra. Ai vijonte t’i gëdhelte këmbët dhe të ngulmonte se kjo qe një çështje që duhej sqaruar një herë e mirë: as Ema dhe as Leoni, në atë situatë në të cilën ndodheshin brenda në pajtonin e Floberit, me perdet të ulura, nuk ia kishin ngenë një kundrimi të tillë, ngenë nuk ia kishte as karrocieri i rraskapitur nga ai udhëtim aventuroz, dhe e gjitha kjo lajthitje teknike, simbas tij, i kishte shpëtuar shkrintarit vetëm e vetëm për një arsye: ngaqë ai nuk donte t’ia dinte se ç’bënin dy personazhet e tij brenda në pajton, me një fjalë nuk i interesonte ajo “seancë marrëdhëniesh”.

Te dera e *Qenit të tërbuar* ua morën palltot dhe kapelet portierët e vjetër, veshur në kostume të kaltra me kopsa prej bakri dhe jaka të kuqe me shirita të praruar anëve. Vajza ishte veshur në një smoking mëndafshi të zi, me kravatë flutur, ndërsa ai në një kostum më të çelët me një kravatë të zezë, që i bënte kontrast me cipën e bardhë të fytyrës. Në hyrjen e sallës së bardhë, që ishte ndarë në dy pjesë të barabarta prej oxhakut me dy gryka, bisedonin të shqetësuar një grup oficerësh. Aty takuan Henry Shackin, një ushtarak që deri dje qe mbajtur si gazetar i pavarur, me mjaft ndikim në rrethet e kadetëve, me një tureçkë të dyshimtë, mjekër ngjyrë çil dhe në një redingotë qesharake. E pyeti kalimthi se çfarë mendonte rreth aksionit bolshevik, për të cilin bëhej aq zhurmë, ndërsa me mend rrekej të kujtonte emrin e vërtetë të gazetarit para se ky ta kishte mbiquajtur veten "Henry". Tjetri ngriti supet e u gërvall:

- Ata janë shkërdhata, - u përgjigj. - Nuk do të guxojnë, por edhe sikur të guxojnë, do t'jua tregojmë vendin. Simbas pikëpamjes sonë, e gjitha kjo që po ndodh nuk ka ndonjë gjë të keqe, sepse ata do të dështojnë me aksionin e tyre dhe nuk do të kenë kurrfarë force në parlament. Ne, përkundrazi, do të konstituojmë një asamble legjislative me dy dhoma, si në SH.B.A. Dhoma e ulët do të përbëhet prej përfaqësuesish të rretheve, kurse dhoma e lartë prej përfaqësuesve të profesioneve të lira, zemstvove, kooperativave ose bashkimeve profesionale.

- Po ju, më falni, jeni me Kerenskin apo me sovjetët? - e pyeti dikur ai.

Pa i kthyer përgjigje, çanë ata midis sallës gjithë muzikë të zhurmshme, kredhur përgjysmë në tym duhani, në

kutërbim djerse e në erëmime parfumeshe, dhe shumë sy u kthyen drejt tyre. Sidomos drejt vajzës. Bërrylet e tyre çikeshin. Me shtatin e hajthëm, me gjirin adoleshent, flokët e shkurtër dhe atë veshje, kishte ajo magjinë dykuptimshe seksuale. Për herë të parë e këqyrte ai nga mbas shpine dhe supet, krahët e ijët e saj iu dukën të mrekullueshme. Ndërsa çanin mes tryezash, një burrë i bëshëm me flokë të zes të lyer pyeti me zë shokun e tij në i pëlqenin homoseksualët. Një term për afërsisht të tillë përdori: *njezhenjki*. Zunë vend në tryezën e tyre, ku gjetën një karafil të zi dimëror. Ajo ndenji duke hedhur këmbën mbi këmbë.

- E shikon sallën? - e pyeti ai.

- Doemos që e shikoj.

- Do të doja ta shikoje mirë.

- Çfarë do me thënë ta shikosh "mirë"?

- Të shikosh mirë do me thënë, për shembull, të dallosh se ndodhemi në një sallë të bardhë me mure të veshura në pasqyra.

- Këtë mund ta përfytyroj, sidoqë përrallat e Hofmanit nuk më pëlqejnë.

- Atëherë me po këtë sy duhet t'i shohësh edhe personazhet.

- Cilët personazhe?

- Këta, - ia bëri shpërfillshëm me dorë, - të gjithë që janë për qark. Personazhe pa fytyra, si në një ballo maskash.

Salla e vallëzimit ishte e madhe dhe, ndonëse të ulurit nëpër tryezat përrreth qenë të shumtë, ata që vallëzonin kishin mundësi të silleshin qark pa u përplasur për tjetrin. Gratë, mbi taka shumë të larta, me vithet e shtrënguara prej fundesh të çara lartazi, me gjinjtë gjysmë të nxjerrë

prej korsazhesh në dantella poliestri, me sytë të ngjyer në blu, me gojën ngjyrëgjake, shkundnin këllqet sensualisht para partnerëve. Krenarë në veshtjet e tyre *la belle époque*, burrat rrotullonin me shpejtësi objektet që mbanin ndër krahë dhe që quheshin “gra”.

Nga njëra prej tryezave pranë burri i mëparshëm vijonte ta vështronte; vajza afroi ndenjësën e vet ngjat heroit, u përkul dhe diç i pëshpëriti. Gjatë uljes e kishte shkopsitur setrën, tani skajonte edhe kravatën flutur, ndërkohë që ai e ndihmonte të shpërthekonte jakën e lartë të këmishës. Sytë e tij u ngulën te gusha e saj, mandej të shtegu i mezidallueshëm mes gjinjve, që ai e përfytyronte qartë. Ishte i sigurt që ajo tanimë ia lexonte dëshirën në sytë dhe në gojën e tij. Ajo, vërtet, u struk mbas tij.

- E ndien që të dua?

Kështu e pyeti ai mbrapa veshit duke ia tërhequr dorën e djathtë drejt të çarës së pantallonave. Njëkohësisht i lëmoi kofshën, sipër pantallonit të ngushtë të smokingut, deri kur u bind që ndjeu nën to mëndafshin e të mbathurave. Ajo i hapi edhe më këmbët për të pranuar përçikjen e dorës së tij, për të ndier ngrohtësinë e saj përmes cohës së ngrirë.

- Më pëlqen të të dua kështu, - i pëshpëriti ai.

- Më pëlqen të të më duash kështu, - ia ktheu ajo.

- Po deshe vërtet të të dua kështu, duhet të pranosh gjithë sa të dhuroj unë.

- Çfarë, për shembull?

- Për shembull, ledhatimet. Edhe ato janë dhuratë. Sikurse janë edhe veshjet. Po ashtu edhe marrëdhëniet mes meshkujsh e femrash, që asgjë më shumë s'janë.

Dhe u vështruan ata sy ndër në sy.

- Të pëlqejnë dhuratat?

Ajo pohoi me kokë, ndërsa në fytyrë i kishte rënë të kuqtë. “Nuk e përfytyroja që *Xhon Ridi* të qenkësh kaq filantrop!”

E qeshura e tij qe e heshtur; ajo i zbuloi dhëmbët. “Mistrece... Duhet ta kuptosh kënaqësinë që ndiej kur të shoh të bukur, domethënë të dëshirueshme. E vure re si të vështruan, ndërsa kaloje nëpër sallë, edhe meshkujt edhe femrat? Më pëlqen që të gjithë të të lakmojnë”. “Nuk bëhesh xheloz?” “Xhelozia nuk hyn në këtë mes. Duhet ta kuptosh se dëshira që kanë të tjerët për ty, të bën edhe më të bukur. Kur jemi njëri pranë tjetrit, nuk të shoh sa duhet. Aty më parë, kur të vështroja së largu se si e përndizje një të panjohur, ishe edhe më shumë imja. Ishe njëherësh ajo që shtrëngoj unë në krahët e mi dhe ajo që josh një tjetër faqe meje për të më pëlqyer mua. Duhet ta dish se është e rëndësishme për çdo femër, virtualisht, t’u premtojë meshkujve diçka që ata e dëshirojnë. Pavarësisht nëse ka ndër mend t’ua japë atë “diçka”, apo jo. Aq më shumë për “romanin” tonë, në të cilin loja e joshjes, e ngashnjimit mes meshkujsh e femrash, nuk luhet pa realizuar përfytyrimin se gjithçka, po gjithçka, është e mundshme. Që të realizohet në të lëvizja ngjitëse, lypset që çdo epizod ta zgjerojë materialin tematik në krahasim me epizodin e mëparshëm.

- Çfarë do me thënë kjo?

- Do me thënë që çdo aventurë e re lypset të përfshijë një tjetër qark personazhesh në fushën e veprimt të heroit ose që çdo aventurë mbasardhëse të jetë më e ndërlikuar dhe më e vështirë se aventura paraardhëse.

Vijuan ata të vështroheshin ndër sy dhe, kësaj radhe, nuk qeshën.

- Po sikur të tjerët të mendojnë se jam *prostitutkë*?

- Ajo çfarë mendojnë të tjerët kurrfarë rëndësie nuk ka. Ka rëndësi vetëm të premtuarit e asaj diçkasë. Të mbajturit e premtimit është çështje tjetër. Vetëm kështu mbërrihet kënaqësia e lakmuar.

- Edhe sikur të paguajnë?

- Paratë? Ato janë diçka e dorës së fundit. Puna është të mos ofrosh asgjë pa provuar vetë kënaqësi.

- Ty do të të pëlqente të prostituohesha?

- “Nuk kam për t’i ndëshkuar bijat tuaja ngase u prostituuan”, thotë një mendje e zgjuar te *Testamenti i Vjetër*.

- Si? - e vështroi ajo e habitur.

- Libri i Osesë, IV, 14, - plotësoi ai qetësisht. - Të prostituuarit është ëndrra e shumë femrave. Po të jetë edhe ëndrra jote, nuk të mbetet veçse ta realizosh.

Ajo mblodhi vetullat, si ta pyeste veten në kishte apo jo ëndrra të tilla. “Ti mendon se të gjithë ëndrrat mund të realizohen në jetë?” Ai shpuri buzën në gaz: “Përsëri nxitohesh. Rëndësi ka që njeriu t’i zbulojë ëndrrat që ndryn brenda vetes, t’i identifikojë ato. Ti, fjala vjen, ndryshe nga unë, duhet të jesh vetëm në hapat e parë të identifikimit të tyre”. “A do të më ndihmoje ti për të hedhur hapa të tjerë...?” Kjo vajzë po e luante mendsh me ngacmimet e saj, me të përqallurit e saj prej maceje.

Ndërsa vështroheshin ata sy ndër sy, në sallë duhej të kishte hyrë një personazh i rëndësishëm, ngase orkestra kishte bërë një pauzë dhe qenë ndier lëvizje e kthime kokash.

- Poetesha e madhe? - e pyeti ajo me të pëshpëritur.

- Në qoftë se ajo është “poetesha e madhe”, unë jam “i panjohuri i shekullit të ardhshëm”, - ia ktheu ai. - Më sak do të ishte ta quanim ish-Luiza Brajant, nxënëse e Dr. Frojdit.

- Që do të thotë...?

- Përderisa e njihje *Xhonin*, duhet ta njohësh dhe *Luizën*.

I hodhi ajo heroit një vështrim pyetës, por ai vetëm sa nënqeshi, se i qe kujtuar shqetësimi nervor i struktur brenda tij.

- Qoftë Luizë, qoftë Joluzë, duhet të ketë qenë shumë e bukur në kohën e saj, - i pëshpëriti vajza, - dua të them atëherë kur e ke njohur ti.

E veshur në një fustan me prerje fare të thjeshtë, që të kujtonte një petk murgeshash, “poetesha e madhe” kishte zënë vend rreth dhjetë tryeza më tej së toku me dy ndër bashkëshortët e saj: të dytin dhe të tretin. Kishte tipare të rregullta, fytyrë vezake klasike, sy të errët shumë të mëdhenj. Mbante një gushore guacash të zeza. Flokët, lehtësisht të përthinjur, të dystë e të lëmuar, i kishte lidhur me një shall ngjyra-ngjyrash. Deshi heroi t’i shpjegonte diçka vajzës që kishte në krah për kohën e kthyeshme e të rikthyeshme, për “të tanishmen e përhershme”, por nuk iu duk vendi i përshtatshëm për shpjegime të atilla, ndaj nxori kutinë e argjendtë të cigareve, mori një dhe e ndezi, veprim të cilin ajo ia shihte për herë të parë.

- A thua do të recitojë? - e pyeti ajo.

- “Por ne do të jemi aq fajtorë, / sa gjithë shekullin XX do ta tronditim”, - shqiptoi ai si t’i fliste vetvetes.

Mandej, për t’iu përgjigjur vështrimit pyetës të vajzës

që kishte pranë, shtoi një fjali të turbullt për të: “Ne të gjithë do të ikim, kur ajo do të mbetet”.

Hangrën pak duke pirë ngadalë. Shiu jashtë duhej të vijonte, mbasi kur e kur, nëpër pauzat e orkestrës, dëgjohej cikrrima e piklave mbi qelqet e sallës. Si hangrën, ai i kërkoi kamerierit një gazetë. *Financial Times*, doemos, nuk kishte. Pra, përfundoi te *Raboçij Put*. Lajmet ishin të papërcaktuara. Trupat e Komitetit Ushtarak Revolucionar kishin zënë pikat strategjike të Jugut, ndërkohë që dy batalione qenë hedhur në anën e Sovjetëve. Arsenali, megjithëkëtë, kishte mbetur në duart e kolonelit Rjabcev dhe të junkerëve të tij. Vajza u ngrit për të vajtur në tualetin që ndodhej në katin e nëndheshëm. Tek çante midis sallës me të ecurën e saj të vendosur, u ndal papritmas, gati duke iu ngatërruar mes gjunjëve burrit të panjohur që vijonte ta përgjonte disa tryeza më përtej. Si për të lypur ndjesë, kaloi dorën mbi mëngën e xhaketës së të panjohurit, i cili ia ktheu me një buzëgaz yndyrshmërisht epshor. Dy burra, që duhej të kishin pirë me të tepërt, i zunë rrugën në të njëjtën kohë për ta ftuar në vallëzim. Ajo u shkëput prej tyre, ndonëse do të kishte dashur të vallëzonte me të dy njëherësh, po të mundte.

Tek delte nga kabina e WC-së, në kthesën e tualetit u ndesh me të panjohurin që kishte zënë vend në këmbë në korridor pranë telefonit me kartë, sikur diç priste. Qe i shëndoshë dhe aspak simpatik. Por një buzëgaz i pacipë dhe goja mishtore seç i jepnin një farë hije. Ajo i buzëqeshi.

- Çfarë gjuhe flisni? - e pyeti ai.

- Vetëm rusishten e pararevolucionit, - kukurisi vajza.

- Nuk besoj se kam për ta harruar ndonjëherë, - shqipton ajo ngadalë thuase numëron rrokjet e fjalëve. - Doemos që nuk ke për ta harruar, - ia kthejnë njëzëri, - po t'i llogaritësh bashkë centimetrat...!

Të dy zgërdhien. Mandej zënë e kuvendojnë “seriozisht”, me një kod që ajo nuk e merr vesh deri në fund: “A thua do të fillojnë së rishti ceremonitë nëpër garazhe?” pyet njëri. “Nuk është aspak çudi”, ia kthen tjetri. “Atëherë ne, çifligarët e modës së vjetër që jetojmë në një shekull të ri, do të jemi kandidatët e parë.” “E di, për shembull, se ç’emër do t’i vënë rrugës *Tvjerskaja*?” pyet njëri dhe shqipton emrin e një shkrimtari të shquar të realizmit socialist. “E kuptueshme. Jo më kot po i thur bejte rebelimit bolshevik.”

Zgërdhien së rishti. Mirëpo zgërdhirja resht shpejt dhe të dy ia ngulin sytë vajzës. Asaj i mbetet filxhani në buzë.

- Ç’patët? - pyet ajo.

- A e ke vënë re se ka një strabizëm ekscitues? - pyet njëri.

- E kam vënë..., - ia kthen tjetri.

Dhe heshtin. I kanë lënë filxhanët. *Xhooon!* i heq vëmendjen ajo heroit. Por ai është ngritur i pari dhe, lakuriq siç është, i afrohet ngjitmas e i vë në dorë mjetin e vet të ngrehur përgjysmë. Çohet edhe tjetri, i vjen nga mbrapa dhe me ngrehjen e vet i ngacmon zverkun, qafën. “A nuk shkojmë edhe një herë në shtrat?” propozon i pari. “Po, por tani vogëlushja duhet të shkojë me dëshirën e vet, me këmbët e veta”, ia kthen tjetri. Ajo është çuar ngadalë, pa e kuptuar as vetë se si, sidoqë këmbët mezi e mbajnë. Ndalë para shtratit. Dhe kthehet nga ata:

- Çfarë tjetër doni të më bëni?

Ata e vështrojnë hijerëndë. Duke ngacmuar çdonjëri mashkullorinë e vet. Dhe kurrnjë përgjigje nuk i kthejnë. Heshtja e tyre asaj i fut frikën. Bie në shtrat. Më shpinë. Nën vështrimet e tyre të ngulta. Pa folur, edhe ata ulen në

shtrat. Mëgjunjazi. Te koka e saj. Të ngrehur. Të përndezur ligsht.

- Ja dhe të vdekurit ku po ngjallen, - ofshan njëri.

- A thua ky është revolucioni për të cilin kemi lexuar? - ia pret tjetri.

- Këtë nuk di ta them. Di vetëm se qenkësh një telash që nuk e ka shokun!

Tani ndodhen sipër vajzës. Ia afrojnë te goja. Ajo kundërshton. Lutet duke u thënë se e ka gojën të dërrmuar. Se nuk mundet më. "A ta ka treguar vogëlushja se si e ka bërë për herë të parë?" pyet njëri. "Jo, e mban ende të fshehtë", ia kthen tjetri. "Fol, - e cysin të dy, - tregona, përndryshe do të ta çapëlejme gojën...". Ajo përpëlitet. Përpigjet t'i largojë buzët prej tyre. Por më në fund fillon të tregojë. Ndërkohë që ata fërkohen sipër gojës së saj.

Dhe përfytyrojnë ata tani mbasditet e fshehta në shtëpinë e saj, kur ajo bën dush me derën e banjës të harruar hapur vetëm e vetëm për t'i rënë në sy të vallait. Ajo bën banjë dhe e thërret të vëllanë në ndihmë për t'ia larë flokët, për t'ia fërkuar shpinën. Intimitetet e saj në ujin e vaskës ndizen, ndërsa i vëllai fryhet brenda pantallonave. Ai i fërkon shpinën, ndërsa ajo, me sy mbyllur, ëndërron sikur ai i prek gjinjtë, ia puth e ia thith. Tregon ajo dhe vijojnë ata të përfytyrojnë mbrëmjen e tij të maturës. Vëlla e motër nuk kanë veçse një vit dallim. Pije. *Techno*. Ajo ka veshur një fustan leshi dhe ka mbathur çorape të qendisura. Kur, më në fund, i vjen radha të vallëzojë me të vëllanë, në gjysmëterrën e diskotekës fillon t'ia fërkojë gjurin e saj mbas kraharorit, mandej nënbarkun mbas kofshës. Dhe e ndien se si ai forcohet gjithnjë më shumë nën pantallona. Dhe

përpiqet të largohet prej saj. Tani dy meshkujt, të përndezur, i bien me dorë mbi gojën e saj, ndërsa ajo u tregon se si i vëllai i thotë se nuk është mirë që e ngacmon ashtu. Dhe i lutet ta falë për mungesën e tij të kontrollit. Ajo, nëpër gjysmë vetëdije, i përgjigjet se kjo i pëlqen. Se kjo e dëfren. Se këtë mezi e ka pritur. Ia pret ai se ajo është e dehur dhe nuk di ç'flet. Mandej ajo u tregon për dhomën, ku ata prej vitesh flenë të dy, dhe shohin ata ekstazën e saj të mbasmesnatës në të gdhirë, lakuriqimin e egër me dritë të fikur. Dy meshkujt mbi të tani janë bërë ujë në djersë, ndërsa shikojnë se si vëllai e hedh mbi shtrat dhe e puth duke i thënë se po marrosët për të. Dhe ajo që ia kthen se për vete është marrosur prej kohësh. Kapërthehen, rrokullisen, kafshohen, ai ia ka zbuluar mishrat e fshehtë, ia puth, ia torturon, deri kur e pllakos përsipër, dhe ajo rënkon, dhe ai i pëshpërit në vesh çfarë i vjen nëpër mend, duke e detyruar edhe atë të përsërisë fjalët e tij, t'i thotë se i pëlqejnë buzët e tij, se i pëlqen seksi i tij, ia quan atë me emra që deri aty më parë as i ka vajtur mendja se mund t'i zërë në gojë, i pohon se çmendet për të, se vdes për ta bërë me të, se do ta bëjë gjithmonë me të dhe vetëm me të, se do të bëhet *prostitutka* e tij, por tashti edhe dy meshkujt sipër gojës së saj i flasin gjithë epushëri e i kërkojnë që të flasë edhe ajo ashtu, dhe vënë re se kjo asaj i pëlqen, se ajo u përgjigjet: po, që të dy më pëlqeni, bini erë të fortë, i keni të mirë dhe unë jua kam qejf, do ta bëj gjithmonë me ju, do të bëj çfarë të më thoni ju, jam *prostitutka* juaj dhe më pëlqen që jam, derisa ata nuk përmbahen dot më, çlirohen me ofshama duke i stërpikur fytyrën, faqet, shtjekat e buzëve, mjekrën, gojën.

Ndërsa bien së rishti mbi shtrat, të rraskapitur, jashtë përtej qelqeve mbi të cilat pasqyrohet flaka e qirinjve, ka filluar të zhvendoset nata e errët, si një përjetësi. Mbase tani edhe karrocierët e Shostakoviçit i ka marrë gjumi. Heroi ka të nxehtë, koka i gjëmon, megjithëkëtë e kupton se atë vajzë që ka pranë e paskësh lakmuar qyshkur, ndoshta prej gjithmonit.

E fundit ditë pa numër

Mbathi papuçet, hodhi krahëve një xhaketë të vjetër kadifeje dhe, si vuri çajnikun në zjarr, i shtiu dru shporetit. Vajza flinte ende dhe ai ndenji në poltronën përkundëse, kundruall kanapesë. Iu bë, se përse, sikur kishte filluar ta donte çdo ditë më shumë. Dhe kjo për të qe e frikshme!

Qenë kthyer në banesën e tij vetëm aty e një orë më parë, të detyruar nga sqota e dëborës që paralajmëronte stuhi të keqe. Të qullur, i kishin ngjitur shkallët me vrap dhe, në ngjitje e sipër, ai ia kishte shkuar dorën nën fund për ta prekur. Madje ajo kishte nisur t'i zbërthente rripin e pantallonave. Kur kishin hyrë brenda, gjysmë të zhveshur, ndërsa flokët e saj kullonin ujë për dysHEME, ai kishte flakur pallton e vet, ajo të sajën, dhe kishin vënë re se asaj edhe fustani i mëndafshhtë kishte nisur t'i ngjitej për lëkurë. Ai e kishte ngritur në krahë, e kishte shtrirë në kanape, kishte nisur t'ia pinte dëborën e shkrirë prej buzëve dhe ia kishte hequr edhe fustanin, ndërsa për vete qe zhveshur vetëm për gjysmë, ngase nuk i durohej sa t'ia kridhte brenda pa asnjë veprim paraprak. Qe çliruar gjatë, duke shtrënguar nofullat, në kohë e sipër që ajo ia kishte mbërthyer parzmin me krahë, a thua se nuk kishte dashur të çlirohej edhe

vetë aq shpejt apo se, për herë të parë, paskësh dashur t'ia sfidonte epshin egoist të mashkullit, botën e mbyllur të ngërçeve vetmitare.

Mbas kësaj, kishte rënë edhe ai më shpinë për të rregulluar frymëmarrjen. Tani dremiste aty, në kanapenë para tij, e mbuluar përgjysmë, dhe ai i kundronte flokët me përshkënditje të lajthinjta, hapërdarë mbi krahun e kanapesë me velenca të kuqe. Iu kujtua si e kishte parë tek i vinte atë ditë, përmes natës me dëborë të hollë dhe hënë, nëpër një bardhësi të përmbinatyrshme: *"Hapi i saj më i lehtë se hija, hëna dhe dëbora më të zbehtë se ajo vetë"*. Filigranat e kangjellave përgjatë *Strastnajës* vezullonin si qëndisma argjendi.

Kishte qëlluar për të një nga periudhat më të amshta, kur e shkante kohën duke lexuar e duke dëgjuar muzikë, të vetmet punë që e argëtonin disi. Bota ia shpifte: i dukej e fëlliqur. Kokën e kishte përplot mendime, që nuk do të donte t' i humbiste. Por ja që kishte përshtypjen se talenti, i paktë a i shumtë, që zotat i patën dhuruar, kishte shkuar e vajtur. Nuk e duronte dot as vetë idenë e të ulurit për të shkruar. Asgjë që t'ia vlente mundimin nuk i ndodhte. Dhe ditët kalonin ngadalë, të gjata e të njëtrajtshme, të mbushura zbrazti. I dukej se shpirti i tij i vjetër ishte i papërtëritshëm. Në atë kohë pati zbuluar vetminë. Ku kishin përfunduar, vallë, siguria dhe krenia, drejtpeshimi i stërpërpiktë i jetës së tij? Kishte madje bindjen që, në çastin kur ajo i qe shfaqur në jetën e tij, atij edhe në fytyrë duhej t' i lexohej pikëllimi, zymnia. Dukesh si një i plagosur që përpiqet t' i fshehë plagët, i kishte thënë kjo vajzë ditën e dytë të takimit të tyre.

Dua të bëj një banjë, kishte thënë vajza, mbas dashurisë. Kur ai qe lakuriquar edhe vetë e qe futur në banjë mbas saj, kishte parë për një çast se si uji nxirrte rrezellime shumëngjyrëshe nga flokët ngjyrëljathi, nga i tërë trupi që farfurinte nën dush. Kishte kundruar hajthmërinë e gjymtyrëve të saj, ngushtinë e mesit, rrafshëtinë e barkut, rrumbullakësinë e vitheve e të kofshëve që çlironin vetëm ephëri, dhe qe mrekulluar: ishte vërtet e bukur!

Ai e kishte rrokur në krahë, qe fërkuar mbas trupit të saj të brylltë dhe ia kishte ngulur dhëmbët në njërin sup. Kujdes, i pati pëshpëritur ajo, tim shoqi nuk ia ka ënda shenjat! Dhe të dy qenë shkrehur në gaz. Ai qe shtirur i tmerruar, i kishte fërkuar gjithë dhembshuri gjurmët e dhëmbëve tij mishin e saj, por ato nuk donin të fshiheshin. Atëherë ajo i kishte shpëtuar nga krahët, qe gjunjëzuar para tij dhe, para se ai të mundte e të kundërshtonte, ia kishte marrë në gojë me aq afsh, sa ai kishte vënë re i mahnitur se i qe ngrehur sa hap e mbyll sy. Faqet e saj gropëzoheshin për çdo të thithur, ndërkohë që gjuha ia mbështillte e ia ledhatonte kryetin ngjyrë manushaqe. Dhe kishte vijuar ajo kështu derisa ai qe gjendur te pragu i shpërthimit, dhe pikërisht atë çast e kishte ndalur në beft veprimin e buzëve të veta, dhe qe zmbropsur për të kundruar veprën e vet që ngrihej krenare e kërcënuese në zbrazti.

Ai u çua ngadalë prej poltronës përkundëse, kërkoi tabaqellën e argjendtë dhe u mat ta ndezte një. Atë çast dëgjoi se si vajza u përpëliti, psherëtiu nëpër gjumë dhe ktheu nënkresën nga ana tjetër. Dhe hoqi dorë nga duhani. Përmes qelqeve përfytyroi breshnizën e dëborës. Kryeqyteti, në revolucion e sipër, shkëndinte nga hëna e plotë.

Gjithçka përjashta ngjante e përendërrshme, magjiplote. Dhe atij, se përse, iu bë se, po të kishte jetë të gjatë, nuk do të ishte çudi që një ditë e gjitha sa po i ndodhte tani t'i dukej një ëndërr ose një histori e lexuar a e dëgjuar diku, një herë e një kohë.

Hoqi nga shporeti çajnikun që po vlonte, e vendosi në tryezë, preu në një pjatë do rriska buke me rozmarinë e me rrush të thatë dhe i gatiti vajzës një filxhan me çaj. Ndërsa bënte veprimin, iu kujtua dridhja e dorës së Aleksej Kirillovit tek shtinte çajin natën e tij të fundit. Ndenji mandej së rishti në poltronën e vet, kundruall kanapesë tek flinte ajo. Ishte përnjëmend e bukur. *"Si det i trazuar nga stuhia"*, përsëriti me vete. Çdo qenie tjetër, që nuk ishte kjo, i dukej një krijesë e padobishme. Tani që mendonte, i vinte keq që ua pati hedhur zemrën fërtele-fërtele femrave të tjera. Dhe kishte ditë tanimë që truri nuk i pranonte kurrfarë pune. Madje as kujtim. Asgjë që mund t'ia largonte mendjen nga i vetmi mendim që e kishte kapluar: i bëhej se për çdo ditë zbulonte tek kjo vajzë një magji të re, një ephëri të panjohur më parë. Dhe e gjitha kjo prej një takimi ta çuditshëm. Por ja që ndodhnin në botë edhe takime të pashpjegueshme, të mistershme. Heroi nuk u besonte Moj-rave, megjithëkëtë e mbinatyrshmja e atij takimi e kishte goditur keq.

Kujtoi se si ajo, vetëm disa minuta më parë, pa dashur t'ia dinte prej lutjeve të tij të heshtura, kishte nisur ta fërkonte nëpër gjithë trupin, nën rrezellimin sylëbyrës të çurgjeve të dushit, duke përdorur një sapun të ermët. E kishte mbështjellë shpejt e shpejt me një shkumë të marrtë, pëllëmbët e duarve të saj i përshkonin një herë kraharorin,

mandej barkun, i zbruanin muskujt dhe vijonin ta vishnin në shkumë. Ajo u frynte flluskave të sapunit, duke qeshur me të kukurisura, i fërkonte shpinën, kofshët, mollaqet dhe, më së fundi, seksin, me një dorë aq të vendosur, sa ai merrte së rishti formën në të cilën ajo e kishte lënë. Ia përçikte herë me pëllëmbët, herë me gishtërinjtë, me të rrëshqitura të shpejta, pa i lënë një çast prehjeje. Ai ndiente valë të nxehti që i ngjiteshin te buzët, i buçitnin te tamblat. Po mbetej pa frymë, po mbytej. Por duart e saj ia patën hequr çdo ndjesi vullneti. Dhe nuk mund të bënte tjetër veçse të bindej, të nënshtrohej, të pranonte zotërimin e atyre duarve, sado kjo t'i kushtonte. Me sytë të përvdirur, mes rrezellimit të çurgjeve, dallonte vajzën që uji i dushit vijonte ta shpëlante si një shtatore shatërvani: ajo i mbante sytë të ngulur mbi ngrehjen e tij, shihte se si kryeti i zbuluar, pavarësisht nga shkuma e sapunit, shndërrohej në të kuqe të errët. Kur e kur, me mollazat e gishtërinjve dhe me goditjet e thonjve, i ngacmonte herdhet dhe hapësirën e ndjeshme përtej tyre, deri te zanafilla e vitheve. Atij i qenë ngurrur kofshët, gjunjët i dhembnin, nuk i mbante dot rënkimet, nën thembra nuk ndiente më mbështetje të sigurtë. Ky është fundi, kishte mundur të thoshte me vete. Është të mosqenët. Dhe unë vetë jam i vdekur. Por një i vdekur i veçantë.

Nuk e priste, kur ajo ia kishte shtrënguar me të gjithë fuqinë e dorës dhe ia kishte tërhequr poshtë lëkurën, sa ta bënte të kërciste. Dhe atëherë një çurgajë e furishme ia kishte stërpikur fytyrën. Por vajza kishte patur kohë, megjithëkëtë, për ta thithur në gojë para se t'i mbaronin ngërçet, për të mbledhur në gjuhën e saj të gjithë lëngun.

Mos lëviz, i kishte thënë mandej, të shpëlah unë. Dhe e kishte shpëlarë. E kishte fshirë. E kishte përqaftuar. Dhe qe fshirë edhe ajo vetë.

Pikërisht atë çast vajza në kanape hapte sytë. I buzëqeshte. Në të bruztën e syve të saj rrokulliseshin valë të qetua, që atij iu dukën se sillnin drejt tij fluturëza të shndritshme. U ngrit dhe iu afrua. Ajo, gjithë ëmbëlsi, i vuri njëren dorë mbi kokë, ndërsa ai i puthte tjetren. Qe një ledhatim si shugurim i flijimit të tij. Mbas kësaj u shkep, u ngrit mbi të. Dhe, o perëndi, së rishti e dëshiroi! Mendimet i vinin si një krijimtari spontane, si mëkati i parë. U shtri ngadalë ngjat saj. I puthi supet, krahët, mbështeti ballin mbi gjinjte e saj dhe iu kujtua si e patën mahnitur ata ditën e parë. Gjysmë e lakuriqar, nën velencën e rrëshqitur, ngjante ajo e paprekshme, e pacenueshme, e paarritshme dhe ai, duke u lutur me mend që ajo të mbetej ngaherë ashtu, e paarritshme, kridhte kokën në fshehtësitë e kurmit të saj për t'ua fashitur etjen buzëve të veta dehur nga erëmmimet. Mirëpo edhe ajo kërkoi me kokë nëpër kurmin e tij, dhe ai u përqeth tek ia ndjeu flokët mbi lëkurë. Tanimë lypsej të bindej përfundimisht se gjithë sa kishte thënë apo shkruar deri atëherë për dashurinë paskëshin qenë përnjëmend broçkulla. Ajo vajzuke atij i duhej. Madje i ishte e domosdoshme. Pikërisht ngaqë i kthente qetësinë e humbur. Dhe ndenjen ata të rrokur kështu njëri me tjetrin, me sy të mbyllur, për një copë herë të gjatë.

- Sa mirë që rrihet kështu! - foli ajo me sytë gjithnjë mbyllur. - Apo jo?

Në gjysmëterrën luhatës të dhomës së ngrohtë, të prapulluar nga çajniku, fytyrat e tyre, pranë e pranë, pluskonin

të qeta, valaviteshin lehtë-lehtë, si të ishin gati për t'u shkëputur nga elementi i paqëndrueshëm mbi të cilin qenë aplikuar. Të mosqenët, tha ai së rishti vetmevete. Që të mund të mendohej për këtë gjendje, u përpoq të qetohej, ta fashiste frymëmarrjen. Por frymëmarrjen e kishte të dridhëruar, mendja i sillej përmbi thellësi pa fund, para të cilave ai donte të zmbrapsej, duke patur frikë për veten.

- Po mendon? - e pyeti ajo.

- Njëri prej nesh duhet të mendojë.

- Dhe pse ti?

- Sepse di gjëra që ti ende nuk ke nga t'i dish.

- Ç'gjëra?

Ai vetëm sa bëri një lëvizje për të ngritur supet, që ajo duhej ta ndiente. Valët e natës, të përbëra prej tingujsh të panumërt, të largët, që afroheshin dhe largoheshin, sillnin deri tek ata zhurma të fikura, por të rregullta, të palodhura. Atje, në katet e sipërme, dringëlliu pianoja e çakorduar. Si për të harruar që ishte i vetëm, u kthye ai nga vajza e e puthi pafundësisht, gati mizorisht, duke e mbajtur për flokësh.

- Nuk të ka shkuar ndonjëherë nëpër mend se unë mund të të dua? - vijoi ajo.

- Mos e përmend këtë fjalë që e shqiptojnë të gjitha gojët. Mes nesh ka diçka tjetër. Më të lartë ose më të ulët, por tjetër.

- Çfarë pikërisht?

- Mos më pyet. Këtë më mirë të mos e dijmë.

- Po çfarë duhet të dijmë?

Ai nuk iu përgjigj, por mundi t'i hapte qepallat përgjysmë dhe të vinte re se, kur qepallat e vajzës u hapën dhe buzët

iu çelën, në ajër u ndie një taft shpërbërjeje ëmbëlcake. Ia morën mendjen sytë e saj pakëz të vangët. Dhe ndiheshin që të dy si në ëndrrat e harruara: u kishte mbetur vetëm ndjesia se diç kishte ndodhur.

- Duhet të iki, - tha ajo atëherë. - Është shumë vonë. Dhe nesër kam për të qenë shumë e lodhur.

- Të kam bërë gati çajin, - tha ai, - dhe ndoshta të është ftohur.

- Duhet..., - përsëriti ajo.

Ai u çua, i zgjati duart për ta ndihmuar të ngrihej, ndërkohë që ajo përsëriste se duhej të ikte, se ishte shumë vonë, se nesër kishte për të qenë shumë e lodhur për në aeroport. Dhe, me të përmendur aeroportin, i shkuan lot. Lotët i rrodhën për fytyrë, përgjatë hundës, deri te shtjekëzat e buzëve. Duke e mbajtur shtrënguar ndër krahë, ai shijoi kripësinë e tyre njëherësh me amzën e papërsëritshme të buzëve të saj.

- Mos qaj, - i tha duke bërë një përpjekje përmbi fuqitë e veta që të mos perlotej edhe vetë. - Do të shihemi përsëri.

- E di. Jam e sigurt. Por jam e lodhur. Dhe më flihet.

E ndihmoi ai të vishej dhe u vesh edhe vetë, duke i kujtuar bisedën e paradisaditshme në ballkonin e terrshëm mbi kënaqësinë si diçka e panatyrshme, marrëdhëniet e stërholluara, çmendurinë e shqisave, të dhënit mbas ngashnjimit. Me sa duket, i tha, erotizmi dhe asgjë tjetër qenkësh thelbi i qytetërimit.

Filxhani me çaj, i pa zënë fill, mbeti në skaj të tryezës. Ndonëse ajo nuk donte që ai ta përcillte, e shoqëroi deri te qoshja e *Moskovskajës*. Dëborë më nuk binte, a thua për të dëftuar se magjepsja paskësh marrë fund. Por nata ishte

shumë e ndritshme. Diçka anormale dukej se ndodhte me motin. Muret e ndërtesave, vende-vende, kishin një bardhësi joreale. Nëpër mure kishin ngrirë, gjysmë të qullura e gjysmë të përbaltura, posterat që njoftonin se fuqitë e mëdha e përshëndetnin revolucionin e vonuar bolshevik. Qenë shtuar edhe parullat e reja: “Kerenski është vrasësi i ushtarëve”. “Kerenski është xhelati i fshatarëve”. “Kerenski është shtypësi i punëtorëve”. Dy autobлиндat që ruanin te kthesa ngjanin si dekor i pikturuar. Dhe të shtëna nuk kishte. Nuk kishte? Kur u ndalën për t’u ndarë, ai e vështroi ashtu të shtangur, hënëlarë, dhe iu duk e pabesueshme që mund ta mbështillte ndër krahë. Ajo shkonte gjuhën mbi buzë, rrihte qerpikët dhe ai nuk mund të mos përndizej. Njëra prej duarve të tij rreth qafës së saj i preku befas damarthin e gushës, që i rrihte furishëm. Dhe u përqeth. Edhe të thithurit e të njëjtit ajër që thithte ajo vajzë e bënte të çmendej. I dridheshin duart. Fytin e kishte të thatë. Dhe nuk fliste dot. Mes këmbëve pantallonat i qenë fryrë. Si do t’ia bënte duke filluar nga e nesërmja e mbrapa? Ajo që ngritur majë gishtërinjve, e puthte drejt e në buzë, ia ngatërronte gjuhën nëpër dhëmbë, dhe shkepej prej tij duke e vështuar me një ngulm të habitshëm deri në fundin e syve.

Kështu u largua me vrap.

- Zot, - klithi ai, - ç’po ndodh kështu me mua?

Ndoshta fajin e kishte vetëm mania e tij për mbrëmjet, kur hijet marrin shpirt, apo ajo sëmundje e çuditshme nervore, që i qe shfaqur muajve të fundit. Atë çast u dëgjuan të shtënat.

Vetëm me mëngjes dhe natë

Dhe erdhi kështu mëngjesi i ikjes. I ikjes së saj. Shtypi dhe TV-të kishin dalë mendsh. Bëhej zhurmë e lemerishme për frigoriferët ku ruheshin pulat, mishi dhe gjalpi për popullin, të cilëve bolshevikët nuk dinin t'u rregullonin temperaturën. Akuzoheshin ish-pushtetarët për grabitjen e një vagoni me patate dhe një me lakra, që qenë shpënë në drejtim të panjohur. Nga ana e tyre, ish-pushtetarët denonconin komisarët e kuq se kishin përvetësuar, pa i rekuizuar, pesë arka me hallvë importi.

Moti ngjante kryekëput i çoroditur, si të paskësh ngatërruar gjithçka. Mbas shakullinave e brymave, dukej sikur kishte ndodhur përmbysja dhe prej horizontit kishin teptisur ca qiej të skuqur zjarr deri në zbardhëllim. Pa kurrfarë kalimi të shkallë-shkallshëm, mbas ftohmës së lagësht të mjegullave dhe shirave, kishte pllakosur një zabullimë që të linte pa frymë. Udhëtonte heroit për në aeroportin e kryeqytetit me një taksitë të vjetër, që kishte vënë flamur italian për t'i shpëtuar rekuizimit dhe, në rrugë e sipër, vështronte i çmeritur se si dielli, a thua i shpurritur prej mashash të tërbuara, qe çelur si gojë furre duke çliruar një dritësim gati të bardhë, që të digjte të pamët. Ishte veshur në kostu-

min e zi, më të mirin, në këmishë të bardhë e kravatë të gjelbër, pa harruar asnjë hollësi të hijeshisë. Në radion e taksisë dëgjoi VOA-në që ritransmetonte debatin e Komisarit të ri të Kulturës me punëtorët. “Cilës klasë të shoqërisë i përkitni ju?” e pyetnin ata. “Jam revolucionar dhe prej njëzet vjetësh ia kam kushtuar jetën time luftës për të drejtat e njeriut dhe për një shoqëri të hapur”, përgjigjej ai. “S’ka rëndësi, - ia kthente një punëtor, - ju jeni një i shitur borgjezisë ndërkombëtare”. Tani heroi e kishte të qartë që nuk qe puna se humbte thjesht atë vajzë. Së toku me të, humbte përgjithmonë edhe aftësinë për të kaluar dy jetët e ndryshme. Mendonte kështu, ndërsa një pluhur flakërues ngrihej prej rrugëve të shkruarëve, duke përcëlluar pemët e thata të dimrit e duke përthekur djerrinat anëve të xhadesë. Kthimi i dritës prej mureve të bardha të aeroportit të verbonte. Një temperaturë fonderie të nxehur vrujonte prej pistës së avionëve.

Vajza e ndoqi për në WC-të e aeroportit. Do të shihemi së rishti, a e kupton që do të shihemi, i pëshpëriste ajo siç qenë rrasur në një nga kabinat e lira, unë do të kthehem, ndërsa shkulte nga duart dorashkat e gjelbëra dhe i shtinte në xhep, i hiqte atij gjithë ankth kravatën, i shkopsiste këmishën, e kuptoj, ia kthente ai, por kjo asnjë rëndësi tanimë s’ka, mjafton të premtosh se s’do t’i harrosh kurrë grimat që kemi kaluar së toku, sepse kujtimet e lumtura s’duhen harruar kurrë, nuk duhen mohuar, ato janë më të forta se koha, të premtoj, ia kthente ajo duke i ulur ngutshëm zinxhirin e *jeans*-eve.

- Për këtë punë kemi ardhur, apo jo? - e ngacmonte.

Zbathte ajo të mbathurat, i shtinte diku, ia rrokte atij

me duar dhe e fuste mes kofshëve të veta gjithë padurim. Dhe iu kujtua atij dita e parë, kur e kishte paraparë gjithë sa më mbas do të bënte me të, në kohë e sipër që një epsh i egër, marramendës i kishte pushtuar të dy. Do ta vononte tani ai me një formalitet tinzar: nxirrte nga xhepi një qes-këz plastike, e shqyente, dhe i zgjaste asaj prezervativin, vështrimin e saj të habitur i përgjigjej me vështrimin e tij cytës dhe me fjalët:

- Me *prostitutkat* duhet treguar gjithnjë kujdes.

Ajo nuk bëzante, por sytë i ishin trazuar. Dhe ai mezi e priste, e adhuronte këtë çast. E dinte që vajzat, më së shumti, nuk janë aspak praktike në kësi veprimesh. Duhet t'i mësosh, t'ua tregosh si veprohet dhe pikërisht prandaj lëvizjet e tyre të ngathta seç kanë një endirë lektisëse: në atë ndërkohë ti mund të shpalosh mashkullorinë tënde, që ato janë të detyruara jo vetëm ta shohin me sy, por edhe ta prekin me duar, të merren gjithsesi me të dhe, ndërsa mjetejt brof nga përdezja, me kryetin jashtë, të manushaqhtë, duart vajzërore dridhen, ngatërrohen, vajzës i ngatërrohen fjalët. Këto veprime zgjatnin gjithnjë pak, tejmase pak, për shijen e tij.

Dhe ja se ku tani ajo, e ngatërruar dhe e emocionuar, nuk ia delte dot, kurse ai që ndezur aq shumë, sa kishte frikë se mos çlirohej para kohe. Atëherë, dorën që ajo ia kishte vendosur pëmbi ia shtrëngoi me dorën e tij, për ta detyruar të lëvizte më ngadalë dhe, me ta ndier që rreziku kishte kaluar, ia liroi së rishti. Mirëpo edhe ajo që ndezur. Kishte hapur kofshët e i dëftonte atij trekëndëshin ngjyrçelët të nënbarkut të saj. Ishte njomur dhe prej mishrave të hapur i çlirohej erëmimi femëror, të cilit ai

nuk kishte mundur t'i bënte ballë kurrrë. Rrëshqiti barkun mbi thupin e saj dhe ajo zuri të rënkonte. U ndal një grimë për ta zgjatur kënaqësinë, mandej, vrazhdësisht, iu kall brenda më një të dyndur të ijeve. E kishte shtypur mbas murit dhe ajo i kishte ngulur thonjtë, e gërvishte, rënkonte, kinse e kishin harruar vendin tek ndodheshin Duke i kafshuar bulën e veshit, ai i pëshpëriste:

- Sa më pëlqen kështu! E ndien? Fol, e ndien?

- Oh, po! Ma bëj! Ma bëj fort! Edhe më fort! Po pri-shem!

Kishin marrë zjarr dhe, kur ai filloi vajtje-ardhjen e ngadaltë, ajo nisi ta lëvizte si e çmendur lugun e barkut për t'ia ndihmuar lëvizjet, ai i pëshpëriste në vesh çfarë t'i vinte nëpër mend, e quante zuskë, kurvickë, rrospi të vogël, por sidomos *prostitutkë*, në një gjuhë që asnjë prej të dyve nuk e njihte, por ai e dinte sa i pëlqente kjo asaj, ajo e dinte sa i pëlqente kjo atij, më fort, më shpejt, i lutej ajo duke rënkuar, dhe ai i shpejtonte goditjet, tani e dinte që ajo krijesë magjepsëse, e jashtëzakonshme, e tejkësajbotshme, qe e tija, e tija përgjithmonë, sepse ajo nuk dinte dëshirë tjetër veç dëshirës së tij, veç të ndenjurit me të, ajo nuk njihte dhe nuk do të njihte askënd tjetër që ta shpinte më larg në rrugët e përfytyrimit, nuk përftonte dot me mend askënd tjetër që t'ia trandte ëndrrat më përdhunshëm e më kënaqshëm se ai, dhe e gjitha kjo në një kohë kur ai do të kishte nevojë për të, për sytë e saj, për zërin e saj, për mendimin e saj, dhe kështu ndjeu ai lëngun e fshehtë tek i ngjitej përpjetë, ia rrëmbushte gjendrat, dhe nuk përmbahej më, madje kishte përshtypjen se edhe ajo po çlirohej, gjithë dëshpërim, dhe njerëzit që mund të ndodheshin në kabinat

ngjitur sigurisht që duhej të dëgjonin gjithçka, por kjo ata vetëm sa i përndizte edhe më, ju duhej të kishit mbajtur asnjësinë, i thoshte dikush dikujt në njërin nga kabinat, kupton apo jo, asnjësinë, kjo nuk varej nga ne, varej nga fshatarësia, ngulmonte tjetri, dhe u çlirua atëherë hero i me një kënaqësi të papërshtueshme, mandej hoqi prezervativin, e vështroi në dritë dhe mbas tij dalloj shëndrizat e syve të saj, e flaku në WC-në dhe shkarkoi ujët, në kohë e sipër që ajo i kishte nxjerrë të mbathurat dhe rrekej t'i mbathte, njëra këmbë i delte huq, dhe ia merrte ai nga dora e i shtinte në një nga xhepat e palltos së vet, që mbrëmanet vonë, para se të flinte, t'u gjente vend diku mes *Aencyclo-pedia Britanica*-s dhe broshurës *A do ta mbajnë dot bolshevikët pushtetin?*

Gjithë ashk, i puthi gojën, ballin, flokët, gushën, para se të delnin nga WC-ja për të vajtur njëri drejt taksisë me flamurin italian dhe tjetra drejt të afërmve që e pritnin për t'u ndarë. "Ke sy të mrekullueshëm, - i tha. - Pak të vangët dhe të pakrahasueshëm". E puthi te dera e WC-së, ngase e dinte që nuk do ta puthte dot në platformën e aeroportit, ajo kthente pëllëmbën e dorës nën gojën e tij për t'ia ndier puthjet brenda pëllëmbës, mes gishtërinjve, përreth pulsit, në të gjitha tejzat, në të gjitha poret, dhe atij i duhej ai çast për t'u bërë i ndërjegjshëm që kurrëmë në jetën e vet nuk kishte për ta patur një vajzë si ajo. Ky ishte fundi. Domethënë, fundi? I dhembnin kërcijtë e këmbëve nga të lodhurit. Palltoja i varej në supe plumb e rëndë. A qe ky një "epilog"? Në të vërtetë, ky nuk qe veçse një nga ato që në teorinë e romanit quhen "përfundime të rrejshme". Logjika e formës romaneske do ta kërkonte, së paku, edhe një për-

zgjatje. Ndërsa largoheshin, ai kthente kokën edhe një herë nga ajo, ajo po shkonte në duar dorashkat e gjelbëra, në gishtërinjtë hollakë që ai ia pëlqente aq shumë, krejt e hutuar, një hop ngatërroi dorashkën e majtë me dorën e djathtë, dhe atij iu kujtua që ngatërrimi i së majtës me të djathtën ndodh ose te mëngjërashët ose te homoseksualët, që në fund të fundit mund të jetë e njëjta gjë, ndërkohë ngrinte sytë edhe ajo dhe e vështronte, diç formuluan me buzë: a thua të dyja gojët u kujtuan për përziemjen e një-hershme.

Si t'ia bëj, pyeti ai veten, si t'ia bëj? Të shpikte ndonjë zgjidhje të re? Por tanimë që shumë vonë për ta ndryshuar të ardhmen. Ai do të kishte nevojë për praninë e saj, veçanërisht do t'ia kishte nevojën pranisë së saj në orët e vetmisë, në dhomën e tij të punës, vonë mbas mesit të natës, mes velencave të kuqe. Mirëpo ja që ajo po i ikte dhe ai kurrigjë më nuk mund të bënte, qoftë edhe për të përftuar efektin e ndonjë zgjidhjeje të papritur. Mos do të kishte bërë më mirë ta kishte nisur të gjithën këtë nga fundi? Apo *in media res*? Për të sajuar një përfundim tjetër, do t' i ishte dashur të ndryshonte fillimin. Tani mbetej vetëm që vajza, e cila po zvogëlohej, të mos e pikaste diçkanë e përmortshme që vihej re në dashamirësinë e tij. Një të ftohtë i mprehtë i sulej drejt zverkut, duke i depërtuar deri në rrënjët e flokëve.

Kështu, pra, në fundin e shekullit, nëpër një mëngjes të akulluar, i ikte ajo dhe shekulli s'tronditej aspak. Shekulli i ri i atdheut të tij, tani e mbrapa, do të interesohet për posterat e rinj të ngjitur nëpër mure, për listat elektorale që do të përcaktonin ndarjen e pushtetit mes socialistësh

revolucionarë, bolshevikësh, kadëtësh e menshevikësh, ndërkohë që mbi heroin e shndërruar në ish-hero të gjitha gjërat e ekzistimit jashtësor nuk do të kishin më veçse një pushtet harrimi. A ka ende trena, pyeste dikush, në kohë e sipër që endej ai nëpër trotuarë, nga sytë-këmbët, për një copë herë pa mbarim, duke menduar për librecin *Nga Kornillovi te Bresti*, që nuk do ta shkruante kurrë, një bandë muzikore u binte marsheve ushtarake, dritësimi i ashpër i jepte të marrura mendsh, gati të vjella, dhe një lodhje të zbrazët, të pashpresë. Në shtëpi, mendoi, duhej të kërkonte në CD *Arjen e Lenskit*.

Me t'u kthyer, gjeti nën derë një njoftim të ri. Më sak: një formular për t'u plotësuar. Titullohej *Formular për borgjezinë*. Dhe erdhi kështu nata, kur ai mbeti i vetëm në dhomën e tij, përpara zjarrit. Me veten e vet. Dhe me pikëllimin e vet. U ndie atëherë kryekëput i vetëdijsëm se si fluturonin të dy sipër oqeanit, si ndodheshin së rishti bashkë, vetëm për vetëm në të njëjtin kompartment të avionit, dhe drita e hënës dyndej prej dritareve vezake, dhe trupi i saj farfurinte si të ishte qenie jashtëtokësore, dhe e gëdhelte ajo, dhe e gëdhelte ai, dhe të dy ishin të bukur, dhe mendtë u vinin rrotull ndërsa vërtiteshin të mbështjellë bashkëfajësisht nëpër vezullimin hënor, dhe yjtë që u silleshin rreth po ata të kohës së parahistorisë ishin, dhe zjarret mes të cilave çanin po ata që kishin ndriçuar udhët nëpër mijëvjeçarë qenë, sepse çfarë mbetej, fundja më në fund, prej dy qenieve të tyre biologjike, çfarë mbetej, pra, prej takimit të tyre të rastësishëm në këtë botë? Një kokë që të frymon mbi sup, një ngërthim frymëmarrës në errësirën e një veture në hyrjen e mbrapme të një vile kontësh të kohës

së carit, erëmimi i mistershëm i kurmit të tjetrit, profili mrekullues dhe një palë buzë që për nga brylltia nuk kanë të dyta, ndërsa qielli rreth tyre lëvizte gjithë pluhuriza yjsh, lulet atje poshtë çelnin e binin, vesku i tyre s'kishte të venitur, përtej tij s' mund të kishte më asgjë, duhej të fillonte asgjësia.

Zgjohej ai në beft prej këtyre ëndërritjeve, pa e kuptuar ku ndodhej. Delte syresh i thyer, i dërrmuar, thujse i asgjësuar.

Gjithçka i sillej në t'errët: sendet, vendet, vitet.

Nuk e gjente dot kohën reale.

Kështu e pikasi që tani asgjëmë nuk ekzistonte.

S'kishte të tanishme të së kaluarës.

As të tanishme të së tanishmes.

Dhe as të tanishme të së ardhmes.

Nuk e kuptonte në delte nga një rajon mjegulle.

Apo hynte në një rajon brymash të reja.

Sepse donte ai tani të harronte dhe s'mundej.

ishikonte kujtimthi ditën e takimit me të.

Gojën që s'do ta përpinte më gojën e tij.

Duart që s'do të shkitnin më mbi kurmin e tij.

Nuk do të kishte më vrambullisje gjaku.

Që sillte mbas vete heshtje e zhgatrrim.

Tanimë avioni atë s'do t'ia kthente.

As Prusti.

As Ajnshtajni.

As Kornillovi s'do ta ngushëllonin dot.

Iu përhi atëherë lëkura e saj.

E shndritshme sa të merrte sytë.

Me brylltinë e jashtëzakonshme.

Pyeste e ripyeste veten nëse kjo paskësh ekzistuar apo jo në realitet, dhe i bëhej sikur e gjitha sa i kishte ndodhur paskësh qenë dje dhe, njëkohësisht, nuk paskësh qenë asnjëherë. Deri atje po mbërrinte sa të vinte në dyshim edhe veten: nëse ai vetë i përkiste apo jo botës reale. I dukej se tanimë e dinte si ishte bota “tjetër”. Dhe pati të ftohtë. E pa veten tek u ngrit, si të bëhej fjalë për një vete të dytë, ndezi dritën dhe kërkoi në një nga syzat e tryezës së punës një flakon *Mutabase*^o. Ndoshta e qetësonte paksa. Në tryezë, pranë takëmit të mermertë të bojës, me kapakë të bakërt, kishte lënë *Formularin për borgjezinë*, që të nesërmen duhej t’ia dorëzonte të plotësuar “komitetit të banesës”. Çapitej mbi qilimin e trashë dhe dëgjonte t’i kumbonin në vesh hapat e vet. Mandej e kapi veten të ndalur para pasqyrës, duke u kundruar. Iu kujtua se dhurimi i shpirtit djallit pikërisht nëpërmjet pasyrës duhej të realizohej. Fytyra që shihte në pasqyrë kishte një verdhësi mjegullore. Syri iu përngja i zbardhëllyer. Vështrimi iu ndal te tamblat, në zanafillë të flokëve, ku *ajo* kishte zakon ta puthte. Dhe iu përkujtua, aty para pasqyrës, gjesti i *saj*: një çurg i hollë i lëngut të tij i kishte rrjedhur teposhtë gushës, *ajo* e kishte marrë me gishtërinj dhe i kishte lëpirë ata gjithë lakmi. Të tjerë do ta zotërojnë tani e mbrapa, mendoi. Të tjera duar do ta prekin, të tjera buzë do ta puthin. Jo më kot ai kishte patur besim te fuqia magjike e pasqyrës. Dhe, me përpikëri të pamëshirshme, iu bë se pa me sytë e vet të tjerët. Pasqyra, me sa shihëj, mbetej e vetmja rrugë me dy kahe: prej nga të vdekurit kthejnë mes të gjallëve dhe anasjelltas.

Zjarri i shporetit qe fikur. Filxhani i çajit, qysh të

mbrëmshmen, kishte mbetur në skaj të tryezës, i ftohur, i pa zënë fill. Nënkresat e kanapesë dhe velencat e kuqe ruanin ende mbresën e trupit që të djeshmen qe kredhur aty. Atëherë ikën dritat. U hutua një copë herë, para se të gjente shkrepëset. “Tri shkrepëset”? Nuk mundi t’ia afronte flakën fitilit të qiriut, kur dëgjoi të trokiturën. Kunji i ndezur iu dogj ndër gishtërinj. Mabajti vesh në t’errët. E trokitura u përsëdyt dhe iu duk e njohur: diçka midis të trokiturës dhe të gërvishturës prej maceje. Ç’po ndodhte, vallë, kështu? Nuk dinte si të bënte: t’i ndizte qirinjtë apo jo. I dukej se, me t’u bërë dritë, e trokitura do të reshtte dhe për të do të fillonte së rishti jeta e rëndomtë, e përbërë prej gjestesh dhe fjalësh të përdorura. Kinse, me të ndezur të qirinjve, do të davaritej ajo çfarë as vetë nuk e saktësonte dot: një frushullimë flatrash, një hije vagullore, një parfum ëmbëlçak. Sikur, po t’u vinte flakën tani atyre qirinjve, do t’i zvenitej përfundimisht *diçkaja* që ekzistonte përtej tij, që ai nuk ishte në gjendje ta rrokte, aq më pak ta shpjegonte, për të cilën do të kishte dhënë gjithçka që ta shpjegonte, por të cilën nuk do ta mësonte, ndoshta, kurrrë.

Mabajti veshin ta ndiente së rishti të trokiturën në derë. Të qe, vallë, vesi i tij i fundit, që të vente të hapte derën pa trokitur kush? Së jashtmi vinte një rrapëllimë që iu bë si zhurma e autobлиндës. U ndal edhe një herë para pasqyrës: iu duk se e trokitura u përsërit, ndërsa ai kishte ngrirë para mesazhit të pasqyrëzuar. Lodhja pa fund e anë, që i qe derdhur nëpër krejt qenien, nuk i kërkonte gjumë: qe një lodhje aq e zbrazët, aq e pashpresë, si një dëshirë fizike për të mos ekzistuar më. Vetja, se përse, iu duk e tepërt.

Vështroi rreth e qark si për të lypur ndihmë dhe atëherë mend mbeti pa frymë: përbri filxhanit të çajit dhe pjatës me feta buke në rozmarinë e rrush të thatë, përskej tryezës, syri i zyri një palë dorashka të gjelbëra. Jo një palë dosido, por dorashkat e *saj*. Në hojzit e hundës ia dha parfumi *white-rose*, që mbushte dhomën. Mendtë iu përziën. Dëgjoi shkoqur zhurmën e shurdhër, ngulmuese, të papërballueshme, të damarëve që i rrihnin, me goditje të dyfishta, nën lëkurën e qafës. E pa veten si të qe gdhirë, ndërsa ende nuk do ta kishte zënë gjumi, do ta ngisnin ethet, dhe do ta kishte të pamundur të mendonte gjë tjetër veç *asaj*, veç pranisë së *saj* që qysh tani e ndiente aty pari, dhe vetja iu duk përnjëmend njeri i tepërt, më i tepërt se Kirillovi, tanimë mbetur përfundimisht pezull diku mes shporetit dhe raftit të librave në mur.

Vjenë 1997 - Tiranë 1998

Biblioteka e "KORBI"-t

1. Ylli PANGO "Amerika"
2. Ylli PANGO "Psikologji Sociale"
3. Robert HORVITZ "Si të ngremë një radio"
4. Charles BUKOWSKI "Femrat"
5. Louis DUMONT "Ese mbi individualizmin"
6. Susan SONTAG "Sëmundja si metaforë e SIDA dhe metaforat e saj"
7. Walter BENJAMIN "Iluminacione"
8. Hannah ARENDT "Mbi Walter Benjamin"-in
9. Luis SEPULVEDA "Ditari i një vrasësi sentimental"
10. Emanuela MOROLI, Roberta SIBONA "Skllavet e Perëndimit"
11. Emile DURKHEIM "Format elementare të jetës fetare"
12. Susan SONTAG "Fotografia"
13. Virgjil MUÇI "Vdekja e pensionistit"
14. Astrid LINDGREN "Pipi Çorapegjata"
15. Aurel PLASARI "Dhjetë ditë që nuk tronditën botën"

Në të gjitha *flirt*-et e deriatëhershme e kishte ndier veten të fortë dhe tejmasë të sigurt. Të shtinte dikë në ngasje, ta joshte, kishte qenë mjaft e lehtë për të. Por po aq e lehtë kishte qenë, mandej, edhe ta skajonte tej. Kurrfarë ndjesie zotërimi nuk e mundonte, kinse për të kishte rëndësi vetëm loja e joshjes në vetvete. Dhe do ti, ja se ku tani, pikërisht kur ishte ndeshur me atë vajzë, e cila i qe futur në jetë në mënyrë aq të beftë, gati të përdhunshme, si të paskësh dalë nga ndonjë prej librave të tij në raft, për të parën herë një ndryshim kishte ndodhur brenda tij.